



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

RAPORT

PËR

**INSPEKTIMIN NË LIDHJE ME PROCESIN E RISTRUKTURIMIT DHE DISA
ASPEKTE TË TJERA TË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL**

KËSHILLI I QARKUT LEZHË

Tiranë, Shtator 2015

RAPORT

Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Lezhë

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të inspektimit, miratuar me vendimin nr.19, datë 11.03.2015, me Vendimin nr.54, datë 08.06.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me administrimin në shërbimin civil, Këshilli i Qarkut Lezhë”, vendosi kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion për verifikimin e gjendjes së ligjshmërisë në gjithë institutet e ligjit, duke nisur nga kuptimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; plotësimi i kushteve ligjore të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67 të ligjit të sipërcituar; lëvizja, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, nëse këto procedura janë bërë sipas parashikimeve të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”; përputhjen e përshkrimeve të reja të punës me modelin e parashikuar nga ligji; plotësimin e kërkesave të përgjithshme e të veçanta të pozicioneve të punës nga punonjësit e mbajtur pas ristrukturimit, etj.

Në zbatim të Vendimit nr. 54, datë 08.06.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me administrimin në shërbimin civil, Këshilli i Qarkut Lezhë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, grupi i inspektimit i përbërë nga Zamira Mujali dhe Ilirjan Osmanlliu, në datën 16.06.2015 kontaktuan me personin e kontaktit, punonjës in ***** , me detyrë përgjegjës i sektorit të Burimeve Njerëzore.

Nga ana e personit të kontaktit na u vu në dispozicion dokumentacioni i kërkuar, i cili u administrua, u nxorën të dhënat e nevojshme dhe u përgatit materiali në vijim, duke u bazuar në objektin dhe qëllimin e inspektimit.

Procesi i inspektimit të përgjithshëm u krye gjatë muajve Qershor-Korrik 2015.

Qëllimi i inspektimit:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”;
- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara e të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit;
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për

përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Objekti i inspektimit:

1. Si janë kuptuar e zbatuar dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, në lidhje me procesin e ristrukturimit (neni 50 i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”.

2. Kontrolli i procesit të ristrukturimit (zbatimi i kërkesave të nenit 50 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij) të institucionit, Këshilli i Qarkut Lezhë, në lidhje me mënyrën e zbatimit të kërkesave të ligjit në fjalë, që nga krijimi i komisionit të ristrukturimit, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në pozicionet e lira ekzistuese, në rastin kur nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme e deri në daljen e vendimit përfundimtar të transferimit, i cili është kompetencë e njësisë së personelit.

3. Rregullimin e ligjshmërisë në procesin e ristrukturimit nëse vërehen shkelje të procedurës dhe kushteve të përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

4. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
- Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm nr.8549, dt.11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, apo për një periudhë më të vogël se 1 (një) vit;
- Nëpunës ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se 1 (një) vit në këto pozicione pune;
- Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil;
- Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve.

Metodologjia e inspektimit

Inspektimi përfshiu verifikimin e procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Lezhë, praktikën e lirit nga shërbimi civil të nëpunësve që iu është shkurtuar pozicioni i punës apo iu janë ndryshuar kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme, për shkak të miratimit të Vendimit nr.18, datë

30.01.2015, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas sektorëve dhe specialiteteve”.

Me shkresën nr.422/2, datë 08.06.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u njoftua institucioni, Këshilli i Qarkut Lezhë, në lidhje me fillimin e inspektimit dhe objektin e tij. Grupi i punës, në datë 16.06.2015, kontaktoi personalisht me personin e kontaktit, *****, me detyrë përgjegjës i sektorit të Burimeve Njerëzore. Nga ana e personit të kontaktit na u vu në dispozicion dokumentacioni i kërkuar, i cili u administrua, u nxorën të dhënat e nevojshme dhe u përgatit materiali në vijim duke u bazuar në objektin dhe qëllimin e inspektimit.

Në zbatim të programit dhe drejtimit të inspektimit të përcaktuar në Vendimin nr.54, datë 08.06.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u verifikua dhe u trajtua dokumentacioni i mëposhtëm në raport me procedurat ligjore:

- Vendimi nr.1, datë 12.02.2014, i Këshillit të Qarkut Lezhë, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas Drejtorive dhe specialiteteve”. Vendimi nr.18, datë 30.01.2015, i Këshillit të Qarkut Lezhë, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas sektorëve dhe specialiteteve”.
- U shqyrtuan aktet e deklaramit të statusit për të gjithë nëpunësit e Këshillit të Qarkut Lezhë, të lëshuara nga njësia e personelit.
- Formularët e përshkrimit të punës për të gjithë pozicionet e shërbimit civil sipas strukturës aktuale të vitit 2015.
- Listëpagesat e muajit Maj 2015 të të gjithë punonjësve të institucionit.
- Vendimet e lirit nga shërbimi civil të ish nëpunësve civilë të Këshillit të Qarkut Lezhë, për shkak të ristrukturimit.
- Urdhri nr.25/1, datë 02.02.2015, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, “Për krijimin e komisionit të ristrukturimit”.
- Urdhrat e emërimit të nëpunësve civilë pas ristrukturimit të institucionit.

Përmbajtja e raportit:

I. Procesi i deklaramit të statusit të punësimit dhe plotësimi i kushteve ligjore për të deklaruar statusin e punësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar e akteve nënligjore në zbatim të tij.

1. a) Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e inspektimit.

Ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2 të tij përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, por njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuar shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit.

Këshilli i Qarkut është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut Lezhë, mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore që përfshihet në fushën e shërbimit civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në të cilin përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Aktualisht, subjekti i inspektimit funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 18, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas sektorëve dhe specialiteteve”, ndërsa në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, datë 26.02.2014, Këshilli i Qarkut Lezhë ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 1, datë 12.02.2014, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas Drejtorive dhe specialiteteve”.

b) Struktura organizative e administratës së Këshillit të Qarkut Lezhë, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, datë 26.02.2014

Sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.1, datë 12.02.2014, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas Drejtorive dhe specialiteteve”, administrata e Këshillit të Qarkut Lezhë kishte gjithsej **41** pozicione pune. Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, rezulton se në këtë institucion ishin **36** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të kategorizuara si më poshtë:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues - **7** (shtatë) pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues - **6** (gjashtë) pozicione pune, që i përkasin pozicionit “shëf sektori, kryeinspektor”;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive - **23** (njëzetetre) pozicione pune që i përkasin pozicionit “specialist”.

2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që Këshilli i Qarkut Lezhë është pjesë e shërbimit civil, deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3: “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit

konkuruuese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë";

- *pika 4: "Nëpunës ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji";*
- *pika 6: "Deklarimi i statusit të punësimit", sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit".*

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", Kreu II, "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", pika 1, është përcaktuar se: "Nëpunës civilë", sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, Komisioneri verifikoi dhe analizoi materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, Vendimin nr.1, datë 12.02.2014, "Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas Drejtorive dhe specialiteteve".

Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni sipas strukturës që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, datë 26.02.2014, mund ta kategorizojmë në këtë mënyrë:

- a. Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr.8549/1999, "Statusi i nëpunësit civil".*

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezulton se nga të gjithë punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, **15** (pesëmbëdhjetë) punonjës janë punësuar në respektim të kërkesave të nenit 13 e vijues të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", me procedura konkurimi.

Nga këqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre rezulton se janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ky ligj. Kështu, është shpallur pozicioni i lirë, është krijuar komiteti *ad-hoc*, ka dalë akti i përzgjedhjes dhe i emërimit, si dhe akti i konfirmimit si nëpunës civilë, për **15** (pesëmbëdhjetë) punonjës sipas përcaktimeve të nenit 13 dhe 14 të ligjit nr.8549/1999, "Statusi i nëpunësit civil".

- b. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.*

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se **19** (nëntëmbëdhjetë) pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion janë plotësuar me akt emërimi të përkohshëm sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 13 të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

c. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të paplotësuara para hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, **2**(dy) pozicionet e punës të paplotësuara para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, ”Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, janë:
Specialist jurist në Drejtorinë Juridike dhe Inspektoratin Ndërtimor;

d. Aktet e certifikimit të statusit sipas përcaktimeve të pikave 3, 4 dhe 6 të ligjit nr.152/2013, ”Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Duke u nisur nga përmbajtja e pikave 3 dhe 4 të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se:

- Në **31** raste nëpunësit civilë kanë një periudhë më tepër se një vit në atë pozicion pune. Nisur nga kjo, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, sipas përcaktimeve të nenit 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë për të gjitha këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në këtë kategori janë:

*****, në pozicionin e “Auditit të Brendshëm”;
*****, në pozicionin “Drejtor i Burimeve Njerëzore”;
*****, në pozicionin “Specialist për teknologjinë e komunikimit”;
*****, në pozicionin “Specialiste e protokollit”;
*****, në pozicionin “Specialist Arkiv-Protokollit”;
*****, në pozicionin “Specialiste për emergjencat”;
*****, në pozicionin “Drejtoreshë e Financës”;
*****, në pozicionin “Specialiste e Financës”;
*****, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik”;
*****, në pozicionin “Specialiste juriste”;
*****, në pozicionin “Drejtoreshë e Zhvillimit Rajonal”;
*****, në pozicionin “Specialiste e politikave të zhvillimit”;
*****, në pozicionin “Specialist i sektorit të hartimit të strategjive”;
*****, në pozicionin “Specialiste për statistikën dhe investimet”;
*****, në pozicionin “Drejtoreshë e Planifikimit të Territorit”;
*****, në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit të Territorit”;
*****, në pozicionin “Specialist i Sektorit të Planifikimit të Territorit”;
*****, në pozicionin “Specialiste e Sektorit të Planifikimit të Territorit”;
*****, në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Hartimit të Strategjive”;
*****, në pozicionin “Specialist për mjedisin”;
*****, në pozicionin “Specialist për hartimin e projekteve”;

*****, në pozicionin “Specialiste për hartimin e projekteve”;
 ***** , në pozicionin “*Specialist i burimeve njerëzore*”;
 ***** , në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë Juridike dhe Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik*”;
 ***** , në pozicionin “*Përgjegjës i Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës*”;
 ***** , në pozicionin “*Inspektor-specialist i Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës*”;
 ***** , në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”;
 ***** , në pozicionin “*Përgjegjëse në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”;
 ***** , në pozicionin “*Specialiste në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”;
 ***** , në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”;
 ***** , në pozicionin “*Specialiste në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”.

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më shumë se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë.

- Në 3 raste, nëpunësit ekzistues janë punësuar në pozicione pjesë të shërbimit civil, por nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sepse kanë një periudhë më pak se një vit në atë pozicion pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, sipas përcaktimeve të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove, për këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove në këtë kategori janë:

***** , me detyrë “*Specialist i politikave të zhvillimit në Drejtorinë e Zhvillimit*”;
 ***** , me detyrë “*Specialist për hartimin e projekteve në Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve*”;
 ***** , me detyrë “*Specialiste në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës*”.

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më pak se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë në periudhë prove.

Konkluzion: Vlerësohet se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit, ka vepruar sipas përcaktimeve të pikave 3, 4 dhe 6 të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe pikës 1 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, ”Për nëpunësin civil”, Kreu II ”Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet*”, kur ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për këto raste.

- *Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuar me akte të përkohshme emërimi pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se 7 (shtatë) pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion janë plotësuar me akte emërimi të përkohshëm sipas dispozitave të ligjit

nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

Konkretisht, pozicionet e punës të plotësuara me akte emërimi të përkohshëm janë:

1. *****, aktualisht ushtron detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, sipas aktit të emërimit nr.26, datë 13.03.2015. Në strukturën paraardhëse ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore sipas aktit të emërimit nr.94, datë 10.09.2014. Emërimi në pozicionin e punës, “Drejtor i Burimeve Njerëzore” është bërë në kundërshtim me ligjin e për rrjedhojë dhe emërimi në pozicionin e përgjegjës të sektorit pas procesit të ristrukturimit është në kundërshtim me ligjin.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.26, datë 13.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

2. *****, “Specialist në Sektorin e Financës”, është emëruar me aktin administrativ nr.38, datë 29.06.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, në vend të *****, e cila është emëruar Drejtoresh e Financës me aktin administrativ nr. 9, datë 09.04.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë. Nëpunësja ***** ka zëvendësuar në këtë funksion nëpunësen *****, e cila është liruar nga detyra e Drejtoresh së Financës dhe është emëruar në detyrën e Auditit të Brendshëm në vend të punonjësit *****, që ka dhënë dorëheqjen. Drejtorja e Financës, sipas Vendimit nr.1, datë 12.02.2014, të Këshillit të Qarkut Lezhë, ka pasur këtë organikë: 1 Drejtor dhe 1 specialist. Lëvizja e mësipërme ka bërë që të mbetet vakant pozicioni i specialistit të financës.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** në pozicionin e specialistit të financës pas hyrjes në fuqi të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.38, datë 29.06.2014 dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

3. *****, “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve”, është emëruar me aktin administrativ nr.17, datë 02.03.2015. Më parë ka pasur detyrën e “Drejtorit të rrugëve rurale”, pozicion ky që nuk përfshihej në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Me Vendimin nr.1, datë 12.02.2014, të Këshillit të Qarkut Lezhë, është krijuar pozicioni i “Drejtorit të Shërbimeve”. Struktura paraardhëse, e miratuar me Vendimin nr.1, datë 20.02.2013, të Kryetarit të

Këshillit të Qarkut Lezhë, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas drejtorive dhe specialiteteve”, nuk e parashikonte pozicionin “Drejtor shërbimesh” dhe as këtë drejtori. Me Vendimin nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Lezhë, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas sektorëve dhe specialiteteve”, Drejtorja e Shërbimeve nuk ekziston më dhe është kthyer në sektor shërbimesh me organikë 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të mësipërm e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.17, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

4. ***** , ”Specialist në Sektorin e Kontrollit të Zhvillimit”, është emëruar me aktin administrativ nr. 18, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë. Konstatohet se më parë ka qenë emëruar në detyrën ”Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve” (me aktin administrativ nr. 34, datë 21.03.2014), pozicion pune i krijuar rishtas me Vendimin nr.1, datë 12.02.2014, të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe ka qenë i paplotësuar deri në emërimin e punonjësit ***** . Struktura paraardhëse e miratuar me Vendimin nr.1, datë 20.02.2013, të Këshillit të Qarkut Lezhë, ”Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas drejtorive dhe specialiteteve” nuk e parashikonte në strukturë “Drejtorinë e Shërbimeve”. Me Vendimin nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas sektorëve dhe specialiteteve”, Drejtorja e Shërbimeve nuk ekziston më dhe është kthyer në sektor shërbimesh me organikë 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë, ku një ndër specialistët është *****.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.18, datë 02.03.2015 dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

5. ***** , “Specialist në Sektorin e Hartimit dhe Monitorimit të Strategjive”, është emëruar me aktin administrativ nr.40, datë 29.04.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, me emërim të përkohshëm, pasi nëpunësja ***** , e cila e ushtronte këtë funksion, ishte me raport mjekësor për shkak të lejes së lindjes.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.40, datë 29.04.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe riemërimi i nëpunëses civile ***** pas përfundimit të raportit mjekësor (leje lindje).

6. *****, "Specialist në Sektorin e Planifimit të Territorit", është emëruar me aktin administrativ nr.36, datë 21.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë. Ky pozicion ka qenë i paplotësuar për shkak të dorëheqjes së nëpunësit civil *****, i cili ka ushtruar më parë këtë funksion.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.36, datë 21.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese".

7. *****, aktualisht "Përgjegjëse e Sektorit të Financës", është emëruar me aktin administrativ nr.25, datë 13.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë. Në strukturën paraardhëse kjo punonjëse ka qenë emëruar me Vendimin nr.09, datë 04.06.2014, të Këshillit të Qarkut Lezhë, në pozicionin e "Drejtorit të Financës", i cili më parë mbahej nga nëpunësja *****, e cila është emëruar në pozicionin e "Auditit të Brendshëm", pozicion ky i lënë vakant nga dorëheqja e nëpunësit *****.

Konkluzion: Emërimi i nëpunëses *****, në pozicionin "Drejtores e Financës" sipas strukturës së vitit 2014 dhe "Përgjegjëse e sektorit të financës" sipas Vendimit nr.18, datë 30.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar. Për rrjedhojë duhet të konstatohet pavlefshmëria e akteve administrative nr.9, datë 04.06.2014 dhe nr.25, datë 13.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese".

Konkluzion: Vlerësoj se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka vepruar në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese", kur ka plotësuar pozicionet e mësipërme me akte emërimi të përkohshme e për rrjedhojë, në kuptim të nenit 115/a dhe 116/c të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative", këto akte emërimi janë absolutisht të pavlefshme dhe këto pozicione duhet të shpallen si të lira.

II. Procesi i ristrukturimit i Këshillit të Qarkut Lezhë

Kriteret bazë mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit (aktet e lirimit të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja) nga ana e njësisë përgjegjëse janë kërkesat e nenit 50 të

ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht:

- Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të këtyre pozicioneve dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre me karakteristikat personale të nëpunësve që janë riemëruar aktualisht në këto pozicione.
- Nëpunësit e riemëruar pas procesit të ristrukturimit, sipas Vendimit nr.18, datë 30.01.2015, "Për miratimin e Strukturës të Administratës së Qarkut Lezhë" të Këshillit të Qarkut Lezhë, gëzojnë apo jo statusin e nëpunësit civil dhe a plotësojnë apo jo kërkesat e përgjithshme e të veçanta për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja.

Konkluzionet e inspektimit të përgjithshëm do të materializohen në vendimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

1/a Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Lezhë para procesit të ristrukturimit.

Nga tërësia e materialeve shkresore të vëna në dispozicion, nga verifikimi i tyre dhe ballafaqimi me ligjin rezultoi se:

Sipas strukturës së mëparshme, të miratuar me Vendimin nr. 1, datë 12.02.2014, "Për miratimin e Strukturës të Aparatit Administrativ të Këshillit të Qarkut sipas Drejtorive dhe Specialiteteve", të Këshillit të Qarkut Lezhë, numri i përgjithshëm ishte **46** punonjës, nga të cilët **36** pozicione përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil dhe struktura e aparatit administrativ të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm :

1. Drejtorja Juridike dhe Inspektorati Ndërtimor, me organikë **1 Drejtor; 1 Kryeinspektor dhe 4 specialistë**, gjithsej **6** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil (2 pozicione pune specialist të paplotësuara).
2. Drejtorja e Burimeve Njerëzore, me organikë **1 Drejtor dhe 3 specialistë**, gjithsej **4** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.
3. Drejtorja e Financës me organikë **1 Drejtor dhe 1 specialist**, gjithsej **2** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.
4. Drejtorja e Shërbimeve me organikë **1 Drejtor dhe 4 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.
5. Drejtorja e Programim Zhvillimit dhe Investimeve me organikë **1 Drejtor, 1 Përgjegjës sektori dhe 3 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.
6. Drejtorja e Planifikimit Territorial, Kontrollit dhe Zhvillimit me organikë **1 Drejtor, 1 Përgjegjës Sektori dhe 3 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune në shërbimin civil.
7. Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës me organikë **1 Përgjegjës Sektori dhe 2 specialistë**, gjithsej **3** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.
8. Drejtorja e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark (funksion i deleguar), me organikë **1 Drejtor, 1 përgjegjës dhe 3 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.
9. Audit i Brendshëm **1** nëpunës civil.

Sa më sipër rezulton se numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë është **36** (*tridhjetegjashtë*), nga të cilët:

- **7** (*shtatë*) Drejtorë Drejtorie (*nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese*);
- **6** (*gjashtë*) Përgjegjës Sektori, Audit i Brendshëm, Kryeinspektor (*nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues*);
- **23** (*njëzetetë*) specialistë (*nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive*).

1/b *Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Lezhë pas procesit të ristrukturimit, miratuar me Vendimin nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Lezhë.*

Sipas Vendimit nr.18, datë 30.01.2015, “*Për miratimin e strukturës së Aparatit Administrativ të Këshillit të Qarkut sipas Sektorëve dhe Specialiteteve*”, të Këshillit të Qarkut Lezhë, që është në fuqi në momentin e inspektimit të përgjithshëm, administrata e Këshillit të Qarkut Lezhë ka gjithsej **43** pozicione pune, nga të cilët **33** pozicione pune në shërbimin civil. Struktura është e organizuar si më poshtë:

1. Sektori Juridik, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori dhe **2** (*dy*) specialistë, gjithsej **3** nëpunës civilë;
2. Sektori i Burimeve Njerëzore, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori dhe **3** (*tre*) specialistë, gjithsej **4** nëpunës civilë;
3. Sektori i Financës, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori dhe **2** (*dy*) specialistë, gjithsej **3** nëpunës civilë;
4. Sektori i Shërbimeve, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori dhe **2** (*dy*) specialistë, gjithsej **3** nëpunës civilë;
5. Sektori i Programim Zhvillimit dhe Investimeve, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori dhe **2** (*dy*) specialistë, gjithsej **3** nëpunës civilë;
6. Sektori i Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori dhe **2** (*dy*) specialistë, gjithsej **3** nëpunës civilë;
7. Sektori i Planifikimit Territorial, Kontrollit dhe Zhvillimit, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori dhe **2** (*dy*) specialistë, gjithsej **3** nëpunës civilë;
8. Sektori i Planifikimit të Territorit, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori dhe **2** (*dy*) specialistë, gjithsej **3** nëpunës civilë;
9. Audit i Brendshëm, **1**(një) nëpunës civil;
10. Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës, me organikë **1** (një) Përgjegjës Sektori, **1** (një) specialist, gjithsej **2** nëpunës civilë;
11. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark (*funksion i deleguar*), me organikë **1** Drejtor, **1** përgjegjës dhe **3** specialistë, gjithsej **5** pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

Sa më sipër rezulton se, me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr. 18, datë 30.01.2015, “*Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Lezhë*”, në këtë institucion, janë **33** (*tridhjetëetë*) pozicione pune, nga të cilët:

- **1** (një) Drejtor Drejtorie (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues*);
- **10** (*dhjetë*) Përgjegjës Sektori (*nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues*);
- **1** (një) Audit i Brendshëm (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues*);
- **21** (*njëzetënjë*) Specialistë (*nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive*).

Nga krahasimi i strukturave arrihet në konkluzionin se institucioni, Këshilli i Qarkut Lezhë, ka kaluar një proces ristrukturimi, ku konstatohet plotësimi i dy kërkesave ligjore: shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe ndryshimi i strukturës organizative. Në strukturën aktuale nuk ekzistojnë si njësi organizative **6** (gjashtë) Drejtori; Inspektorati Ndërtimor është shkruar me Drejtorinë Juridike, si dhe është shkurtuar numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë: nga **36** (tridhjetegjashtë) që ishin me strukturën e mëparshme, me strukturën aktuale janë efektive vetëm **33** (tridhjetetë) nëpunës.

- *Gjendja e respektimit të kërkesave ligjore për përshkrimin e punës dhe respektimi i kërkesave ligjore për zbatimin e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave.*

Sipas parashikimeve të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të Këshillit të Ministrave, është njësi përgjegjëse ajo që drejton gjithë procesin nga ana ligjore. Ajo përcakton kriteret e vendeve të reja të punës, pas ristrukturimit dhe krijon komisionin e ristrukturimit, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese. Komisioni i ristrukturimit i propozon me shkrim njësisë përgjegjëse transferimin e nëpunësit dhe e mbështet propozimin e tij mbi kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënat e nëpunësve civilë. Pas kësaj procedure është njësi përgjegjëse, e cila ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirim nga shërbimi civil të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës dhe u ka ndryshuar përshkrimi i punës, pas propozimit të bërë nga komisioni i ristrukturimit.

Përshkrimet e reja të punës i kanë paraprirë procesit të ristrukturimit, sipas pikës 14 "Procedura dhe formati i përshkrimit të punës", të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të Këshillit të Ministrave. Ndryshimi i mënyrës së organizimit të Këshillit të Qarkut Lezhë është diktuar nga ligji nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015". Nuk ka ndryshime të detyrave dhe përgjegjësi kryesore të pozicioneve të punës. Janë mbajtur po ata nëpunës me ndryshimin se nëpunësit që kanë qenë në pozicionin e drejtorit janë riemëruar përgjegjës sektori, për arsye se nga ana e njësisë përgjegjëse më shumë rëndësi i është kushtuar ruajtjes së pozicioneve të punës, duke reduktuar pagat dhe duke ulur kategoritë e pozicioneve të punës nëpërmjet riklasifikimit, bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të Këshillit të Ministrave (pozicionet "drejtor" nuk ekzistojnë dhe janë ulur nivelet e pozicioneve të punës nga kategoria A në B për pozicionet "përgjegjës" dhe nga A në D për pozicionet "specialist").

Konkluzion: Gjithë procedura administrative e parashikuar në nenin 50 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin

e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, konstatohet se është zbatuar vetëm nga ana formale, duke i kushtuar më shumë rëndësi ruajtjes së pozicioneve të punës. Për këtë arsye, janë reduktuar pagat dhe ulur kategoritë e pozicioneve të punës nëpërmjet riklasifikimit, bazuar në nenin 19 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave (pozicionet “drejtor” nuk ekzistojnë dhe janë ulur nivelet e pozicioneve të punës nga kategoria A në B për pozicionet “përgjegjës” dhe nga A në D për pozicionet “specialist”).

III. Procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të riemërimit në shërbimin civil të nëpunësve pas ristrukturimit të institucionit, komenti ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.

Me Urdhrin nr.25/1, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Administratës së Këshillit të Qarkut Lezhë”, dalë në bazë e për zbatim të Vendimit nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Lezhë, “Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Lezhë”, nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr.171, dt. 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit. Ky komision, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e nevojshëm ligjor (*dosjen personale*), përshkrimet e punës të pozicioneve të ristrukturuara, kriteret specifike të vendeve të lira të krijuara, vlerësimin vjetor dhe vjetërsinë në punë të secilit nëpunës, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr.171, dt. 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, ka bërë propozimet përkatëse para njësisë së personelit.

Nisur nga gjithë sa u tha më sipër, njësia e personelit ka pranuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit dhe ka nxjerrë aktet e riemërimit pas ristrukturimit.

Konkluzion: Konstatohet se, në rastin kur ka pasur ulje në detyrë të punonjësit nuk është marrë mendimi i tij me shkrim për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikat 19 dhe 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, por kjo parregullsi nuk e bën të pavlefshëm vendimin e emërimit, i cili i plotëson kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave.

- *Aktet e emërimit pas ristrukturimit të institucionit, sipas Vendimit nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Lezhë, “Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Lezhë”:*

1. Punonjësja *****, me aktin administrativ nr.12, datë 10.07.2014, është emëruar në detyrën e “*Auditit të Brendshëm*” (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues). Më parë nëpunësja ka qenë emëruar “*Drejtores e Financës*”, me aktin nr.99, datë 18.08.2006 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.26, datë 11.06.2014). Nëpunësja plotëson kërkesat e posaçme (arsimi i lartë Fakulteti Ekonomik, mbi 5 vjet eksperiencë pune) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Nëpunësja në fjalë ka zëvendësuar në detyrë nëpunësin civil *****, i cili ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga detyra në datë 15.06.2014 e, për këtë shkak, në kuptim të nenit 66, pika 1/dh, është liruar nga shërbimi civil.

Konkluzion: Emërimi i nëpunëses ***** në detyrën e “*Auditit të Brendshëm*” (kategori më e ulët) është bërë pa marrë paraprakisht deklaramin me shkrim të nëpunëses, nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave. Njësia përgjegjëse nuk ka nxjerrë aktin e riemërimit të nëpunëses, detyrim i parashikuar në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

2. Punonjësi *****, me aktin administrativ nr.94, datë 10.09.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në detyrën “*Drejtor i Burimeve Njerëzore*” (nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese). Më parë, nëpunësi ka kryer detyrën “*Specialist i Politikave të Zhvillimit në ish Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal dhe Integritimit*”, me Vendimin nr.24, datë 31.12.2013 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.2, datë 18.06.2014, në pozicionin specialist). Pas ristrukturimit të institucionit, nëpunësi është riemëruar me Urdhrin nr. 26, datë 13.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, në pozicionin “*Përgjegjës i sektorit të burimeve njerëzore*”.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit civil ***** në pozicionin “*Drejtor i Burimeve Njerëzore*” me aktin administrativ nr. 94, datë 10.09.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe riemërimi i tij pas ristrukturimit me aktin administrativ nr.26, datë 13.03.2015, janë në kundërshtim me nenet 25 dhe 26 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave. Në këto kushte, duhet të konstatohet pavlefshmëria e akteve të emërimit nr.94, datë 10.09.2014 dhe nr. 26, datë 13.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, në kuptim të neneve 115/a dhe 116/c të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative*” dhe të shpallet pozicioni i punës si i lirë.

3. Punonjësi *****, me aktin administrativ nr.22, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në detyrën “*Specialistit i teknologjisë së informacionit*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore (nëpunës civil i kategorisë ekzekutive). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë, por në ish Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, emëruar me aktin administrativ nr.16, datë 11.06.2012 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.23, datë 11.06.2014). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (arsimi i lartë

inxhinieri elektronike, mbi 5 vjet eksperiencë pune) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

4. Punonjësja ******, me aktin administrativ nr.24, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në detyrën “*Specialiste protokolli*” në Sektorin e Burimeve Njerëzore (*nëpunëse civile e kategorisë ekzekutive*). Më parë ka qenë nëpunëse civile në të njëjtën detyrë, por në ish Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, emëruar me aktin administrativ nr.36, datë 19.03.2004 (*akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.24, datë 11.06.2014*). Kjo nëpunëse plotëson kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës, sepse ka mbi 11 vjet që e ushtron këtë detyrë.
5. Punonjësi ******, me aktin administrativ nr.25, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në detyrën e “*Specialistit të Arkivit*” në Sektorin e Burimeve Njerëzore (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive*). Më parë ka qenë nëpunës civil në të njëjtën detyrë, por në ish Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, emëruar me aktin administrativ nr.108, datë 26.04.2010 (*akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.25, datë 11.06.2014*). Nëpunësi ****** plotëson kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës, sepse ka mbi 5 vjet që e ushtron këtë detyrë dhe ka mbaruar Fakultetin Ekonomik.
6. Punonjësja ******, me aktin administrativ nr.25, datë 13.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në detyrën e “*Përgjegjëses së Sektorit të Financës*” (*nëpunës civil i kategorisë së ulët drejtuese*). Para ristrukturimit nëpunësja ka ushtruar detyrën e “*Drejtores së Financës*”, emëruar me aktin administrativ nr. 09, datë 04.06.2014 (*aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.27, datë 11.06.2014, e ka si specialiste.*).

Konkluzion: Emërimi i nëpunëses ******, në pozicionin “*Drejtores së Financës*” sipas strukturës së vitit 2014 dhe në atë të “*Përgjegjëses së sektorit të financës*” sipas Vendimit nr.18, datë 30.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, bazuar në nenin 115/a dhe 116/c të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative*”, duhet të konstatohet pavlefshmëria e akteve administrative nr.9, datë 04.06.2014 dhe nr.25, datë 13.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”.

7. Punonjësi ******, me aktin administrativ nr.38, datë 29.06.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Financës*” (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive*). Emërimi i nëpunësit është bërë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar. Pas ristrukturimit të institucionit, me anë të Vendimit nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Lezhë, nëpunësi vazhdon të kryejë të njëjtën detyrë në Sektorin e Financës, sipas Vendimit nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Lezhë.

Konkluzion: Pozicioni “*Specialist i financës*” ka qenë i paplotësuar si rezultat i emërimit të punonjësës ****** nga “*Specialist Finance*” në “*Drejtores së Financës*”. Emërimi i nëpunësit

***** në pozicionin e “*Specialistit të Financës*”, i cili ishte vakant nga lëvizja e sipërcituar, është kryer në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave. Në këto kushte, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit në kuptim të neneve 115/a dhe 116/c të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative*” dhe të shpallet pozicioni i punës si i lirë.

8. Punonjësi ***** , “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve*”, me strukturën aktuale, emëruar me aktin administrativ nr.17, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë. Më parë ka kryer detyrën e “*Drejtorit të rrugëve rurale*”. Me Vendimin nr.1, datë 12.02.2014, është krijuar pozicioni i “*Drejtorit të Shërbimeve*”, i cili ka qenë i paplotësuar gjatë gjithë vitit 2014. Struktura paraardhëse e miratuar me Vendimin nr.1, datë 20.02.2013, të Këshillit të Qarkut Lezhë, “*Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas drejtorive dhe specialiteteve*”, nuk e parashikonte pozicionin “*Drejtor shërbimesh*”, dhe as këtë drejtori. Me Vendimin nr.18, datë 30.01.2015, “*Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas sektorëve dhe specialiteteve*”, të Këshillit të Qarkut Lezhë, Drejtoria e Shërbimeve nuk ekziston më dhe është kthyer në sektor shërbimesh me organikë 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Në pozicionin e përgjegjës të sektorit është emëruar punonjësi *****.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.17, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”.

9. Punonjësi ***** , me aktin administrativ nr.19, datë 10.02.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar “*Specialist për transportin dhe infrastrukturën*” në Sektorin e Shërbimeve (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv*). Para ristrukturimit nëpunësi ka ushtruar detyrën e “*Drejtorit të Burimeve Njerëzore*”. Me Urdhrin nr.94, datë 10.09.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është liruar nga kjo detyrë dhe është emëruar “*Specialist për transportin dhe infrastrukturën*” në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale, akt i cili është pranuar nga nëpunësi civil (*akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.22, datë 11.06.2014, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë*).

10. Punonjësi ***** , “*Specialist në Sektorin e Kontrollit të Zhvillimit*”, emëruar me aktin administrativ nr. 18, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë. Me aktin administrativ nr. 34, datë 21.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në detyrën “*Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve*”. Pozicioni i specialistit të Shërbimeve është pozicion pune i krijuar rishtas me Vendimin nr.1, datë 12.02.2014 dhe ka qenë i paplotësuar deri në emërimin e punonjësit ***** . Struktura paraardhëse, e miratuar me Vendimin nr.1, datë 20.02.2013, “*Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas drejtorive dhe specialiteteve*”, të Këshillit të Qarkut Lezhë,

nuk e parashikonte në strukturë Drejtorinë e Shërbimeve. Me Vendimin nr.18, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut Lezhë sipas sektorëve dhe specialiteteve”, të Këshillit të Qarkut Lezhë, Drejtoria e Shërbimeve nuk ekziston më dhe është kthyer në sektor shërbimesh me organikë 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.18, datë 02.03.2015 dhe të shpallet procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

11. Punonjësja ***** me aktin administrativ nr.19, datë 02.03.2015, është emëruar në pozicionin “Specialiste e arsimit, kulturës dhe sporteve” në Sektorin e Shërbimeve (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë, por në ish Drejtorinë e Shërbimeve, emëruar me aktin administrativ nr.1209, datë 01.05.2008 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.29 datë 11.06.2014). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (arsimi i lartë Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega Bio-Kimi, mbi 5 vjet përvojë pune) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

12. Punonjësja ***** me aktin administrativ nr.30, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “Specialist e emergjencave civile dhe shërbimeve sociale” në Sektorin e Shërbimeve (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtin pozicion, por në ish Drejtorinë e Shërbimeve, emëruar me Urdhrin nr.14, datë 27.03.2012 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.30, datë 11.06.2014).

13. Punonjësja ***** me aktin administrativ nr.31, datë 26.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar “Përgjegjëse e Sektorit të Programim Zhvillimit” (nëpunëse civile e nivelit të ulët drejtues). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në detyrën “Drejtor i Zhvillimit Rajonal dhe Integritit”, emëruar me aktin administrativ nr.13, datë 13.04.2001 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.31, datë 11.06.2014). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës dhe ka pasur përparësi në emërim, sepse më parë ka kryer detyrën e drejtorit të drejtorisë.

Konkluzion: Riemërimi i nëpunëses ***** në detyrën “Përgjegjëse e Sektorit të Programim Zhvillimit” (kategori më e ulët) është bërë pa marrë paraprkisht deklaramin me shkrim të nëpunëses nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

14. Punonjësi ***** me aktin administrativ nr.32, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i sektorit të Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive” (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues). Para

ristrukturimit nëpunësi ka ushtruar detyrën e “Drejtorit të Menaxhimit të Projekteve”, emëruar me aktin administrativ nr.4/4, dt. 23.01.2012 (akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.32, dt.11.06.2014). Ky nëpunës ka pasur përparësi në emërim, pasi më parë ka ushtruar funksionet e drejtorit të drejtorisë.

Konkluzion: Riemërimi i nëpunësit ***** në detyrën “Përgjegjës i sektorit të Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive” (kategori më e ulët) është bërë pa marrë paraprakisht deklarimin me shkrim të nëpunësit nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

15. Punonjësi ***** me aktin administrativ nr.33, datë 02.03.2015, është emëruar “Specialist në sektorin e Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive” (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv). Më parë nëpunësi ka qenë me detyrë “Përgjegjës i sektorit të Bashkëpunimit dhe Integritimit” në ish Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal dhe Integritimit. Fillimi i marrëdhënies së punës është bërë me aktin nr.4/3, datë 23.01.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.33, datë 11.06.2014. Nëpunësi në fjalë ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar funksionet e përgjegjës të sektorit.

Konkluzion: Riemërimi i nëpunësit ***** në detyrën “Specialist i Sektorit të Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive” (kategori më e ulët), është bërë pa marrë paraprakisht deklarimin me shkrim të nëpunësit nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

16. Punonjësi ***** “Specialist në Sektorin e Hartimit dhe Monitorimit të Strategjive”, është emëruar me aktin administrativ nr. 40, datë 29.04.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë. Pozicioni i sipërcituar është vakant për shkak se nëpunësja civile ***** e cila e ushtronte këtë funksion është me raport mjekësor për shkak të lejes së lindjes.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të sipërcituar e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.40, datë 29.04.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe riemërimi i nëpunësve civile ***** pas përfundimit të raportit mjekësor (leje lindje).

17. Punonjësja ***** me aktin administrativ nr. 35, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë është emëruar “Specialiste e analizës, statistikës dhe investimeve në sektorin e Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive” (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv). Para ristrukturimit, nëpunësja ka ushtruar të njëjtën detyrë në ish Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal dhe Integritimit, emëruar me aktin administrativ nr. 141, datë 04.09.2007 (akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.35, datë 11.06.2014).

18. Punonjësja ***** me aktin administrativ nr.30, datë 26.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar “Përgjegjëse e sektorit të Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit” (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues). Para ristrukturimit

nëpunësja ka ushtruar detyrën e “Drejtorit të Planifikimit të Territorit, Planifikimit dhe Inspektimit”, emëruar me aktin administrativ nr.17, datë 11.04.2012 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.36, datë 11.06.2014). Kjo nëpunëse ka pasur përparësi në emërim, pasi më parë ka ushtruar funksionet e drejtorit të drejtorisë.

Konkluzion: Riemërimi i nëpunëses ***** në detyrën “Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit” (kategori më e ulët) është bërë pa marrë paraprakisht deklaramin me shkrim të nëpunëses nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”.

19. Punonjësja ***** me aktin administrativ nr.37, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë është emëruar “Përgjegjëse e sektorit të Planifikimit të Territorit” (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues). Para ristrukturimit nëpunësja ka ushtruar të njëjtën detyrë në ish Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Projektimit dhe Inspektimit, emëruar me aktin administrativ nr. 20, datë 01.03.2012 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.37, datë 11.06.2014).

20. Punonjësi ***** “Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit” emëruar me aktin administrativ nr.36, datë 21.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë. Pozicioni “Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit” ka qenë i paplotësuar për shkak të dorëheqjes të nëpunësit civil ***** , i cili ka ushtruar më parë këtë funksion.

Konkluzion: Emërimi i nëpunësit ***** pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit të mësipërm e për rrjedhojë, duhet të konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ nr.36, datë 21.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë dhe të nisë procedura për plotësimin e vendit vakant, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

21. Punonjësja ***** me aktin administrativ nr.39, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar “Specialiste e administrimit të territorit në sektorin e Planifikimit të Territorit” (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv). Para ristrukturimit nëpunësja ka ushtruar të njëjtën detyrë në ish Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Projektimit dhe Inspektimit, emëruar me aktin administrativ nr.25, dt.01.03.2012 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.39, dt.11.06.2014).

22. Punonjësi ***** me aktin administrativ nr.27, datë 13.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i sektorit juridik” (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues). Para ristrukturimit nëpunësi ka ushtruar detyrën e “Drejtorit të Çështjeve Ligjore dhe Inspektoratit Ndërtimor”, emëruar me aktin administrativ nr.48, datë 03.02.2003 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr. 40, datë 11.06.2014). Nëpunësi në fjalë ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar funksionet e drejtorit të drejtorisë.

Konkluzion: Riemërimi i nëpunësit ***** në detyrën “Përgjegjës i Sektorit Juridik” (kategori më e ulët) është bërë pa marrë paraprakisht deklarimin me shkrim të nëpunësit nëse pranon detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

23. Punonjësja ***** me aktin administrativ nr.41, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar “Specialiste për shërbimet juridike në Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Inspektoratit Ndërtimor” (nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv). Më parë nëpunësja ka ushtruar të njëjtën detyrë; fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.1, datë 29.10.2004 (akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.41, datë 11.06.2014). Nëpunësja plotëson kërkesat e posaçme sipas përshkrimit të ri të punës (arsimi i lartë, Dega Drejtësi, mbi 5 vjet eksperiencë pune) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.
24. Punonjësi ***** me aktin administrativ nr.48, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “Specialist në sektorin e burimeve njerëzore” (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv). Më parë nëpunësi ka ushtruar detyrën e “Specialistit në ish Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Inspektoratit të Ndërtimit”; fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.23, datë 09.03.2009 (akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.48, datë 11.06.2014). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme sipas përshkrimit të ri të punës (arsimi i lartë, Dega Drejtësi, mbi 5 vjet eksperiencë pune, vlerësime pozitive të dy viteve të fundit) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.
25. Punonjësi ***** me aktin administrativ nr.47, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “Specialist i Financës” (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë, por në ish Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Inspektoratit të Ndërtimit, emëruar me aktin nr.4, datë 11.11.2011 (akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.47, datë 11.06.2014).
26. Punonjësi ***** me aktin administrativ nr.21, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “Specialist në sektorin e planifikimit të territorit” (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv). Para ristrukturimit nëpunësi ka ushtruar detyrën e “Specialistit të hartimit të projekteve” në Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve, emëruar me aktin administrativ nr.28, datë 31.12.2013 (akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.21, datë 11.06.2015, nëpunës civil në periudhë prove).
27. Punonjësi ***** me aktin administrativ nr.24, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “Specialist në sektorin juridik” (nëpunës civil i kategorisë ekzekutive). Para ristrukturimit nëpunësi ka ushtruar detyrën e “Specialistit të hartimit të projekteve” në Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve, emëruar me aktin administrativ nr.22, datë 02.12.2013 (akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.22, datë 11.06.2015, nëpunës civil në periudhë prove).
28. Punonjësi ***** me aktin administrativ nr.50, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës” (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues). Para ristrukturimit nëpunësi ka pasur detyrën e “Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes”, emëruar me aktin administrativ nr.10, datë 15.02.2012 (akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.50, datë

11.06.2014). Nëpunësi në fjalë ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar detyrën e Kryeinspektorit.

29. Punonjësi *****, me aktin administrativ nr.26, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “*Inspektore në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës*” (nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv). Më parë nëpunësja ka kryer të njëjtën detyrë, emëruar me aktin nr.26, datë 31.12.2013 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.4, datë 11.06.2014, nëpunëse civile në periudhë prove).
30. Punonjësja *****, me aktin administrativ nr.32, datë 24.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*” (funksion i deleguar, nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues). Ky pozicion në momentin e emërimit të punonjësës ka rezultuar i lirë. Nëpunësja, bazuar në nenin 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, gëzon statusin e nëpunësit civil në periudhë prove dhe ka zëvendësuar nëpunësin *****, të cilit, bazuar në nenin 65, pika 1/d, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, i ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil. Me Urdhrin nr.4, datë 13.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, nëpunësi ***** është liruar nga shërbimi civil për shkak të vendimit penal nr.233, datë 08.05.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, me Vendimin nr.501, datë 22.12.2014.
31. Punonjësja *****, është riemëruar “*Përgjegjëse në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës*”. Fillimi i marrëdhënies së punës është bërë me aktin nr.31, datë 12.07.2001 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.43, datë 11.06.2014).
32. Punonjësi *****, është riemëruar “*Inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës*”. Fillimi i marrëdhënies së punës është bërë me aktin nr.29, datë 10.07.2001 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.44, datë 11.06.2014).
33. Punonjësja *****, është riemëruar inspektore në “*Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës*”. Fillimi i marrëdhënies së punës është bërë me aktin nr.39, datë 11.09.2001 (akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.45 datë 11.06.2014).

Konkluzion: Drejtorja e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (*Funksion i Deleguar*), nuk ka pasur ndryshime strukturore dhe as të emërtesave. Nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore nuk janë bërë aktet e riemërimit me arsyetimin se nuk ka ndryshime të kriterëve të posaçme dhe të përshkrimit të punës.

Konkluzion i përgjithshëm: Konstatohet se, kriteret e ndjekura (*formularët e përshkrimit të punës*) nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Njësia Përgjegjëse, bazuar në kompetencat ligjore të parashikuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave, në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të emërimit, kanë qenë në funksion të mënyrës së re të organizimit të Këshillit të Qarkut Lezhë.

Riemërimet e nëpunësve civilë në pozicione të një kategorie të barabartë ose më të ulët janë bërë pa marrë paraprakisht deklarimin me shkrim të nëpunësit nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”.

IV. Procedura ligjore e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të lirit nga shërbimi civil i nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, komenti ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.

Me Vendimin nr. 18, datë 30.01.2015, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës për vitin 2015*”, të Këshillit të Qarkut Lezhë, Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 50, pika 3, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.171, dt.26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, i ka propozuar njësisë përgjegjëse nëpunësit që do të lirohen nga shërbimi civil në pamundësi sistemimi për shkak të shkurtimit të pozicionit të punës. Nëpunësit të cilët janë propozuar për t’u liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit janë si më poshtë:

1. Punonjësja *****; ish nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, me detyrë “*Inspektore në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës*”. Aktin e certifikimit të statusit nr.42, datë 11.06.2014, nëpunësja e ka në pozicionin e mësipërm. Me vendimin nr.16, datë 02.03.2015, të Njesisë Përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësës ***** nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Lezhë, konstatohet se Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës, nga tre pozicione pune që ka pasur - 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë, aktualisht me strukturën e re ka dy pozicione pune - 1 përgjegjës dhe 1 specialist. Provohet se është shkurtuar një pozicion pune specialist.

2. Punonjësi *****; ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë “*Specialist për hartimin e projekteve*” në ish Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve. Aktin e certifikimit të statusit nr.38, datë 11.06.2014, ***** e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.16/1, datë 02.03.2015, të Njesisë Përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit nga shërbimi civil, pasi në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.18, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Lezhë, nuk ekziston Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve. Funksionet e drejtorisë së mësipërme i kanë kaluar Sektorit të Programim, Zhvillimit dhe Investimeve me organikë 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë, nga 4 specialistë që ishin në organikë në strukturën e mëparshme (*provohet shkurtimi i dy pozicioneve të punës “Specialist”*).

Konkluzion: Konstatohet se të dyja aktet e lirit të nxjerra nga njësia përgjegjëse kanë dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimit nr.171 datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave. Konkretisht, nëpunësit, të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës, janë njoftuar 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe, në përputhje me vjetërsinë, iu kanë dhënë të drejtën e dëmshpërblimit

sipas përcaktimeve të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr.171, dt. 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave.

KONKLuzion:

Nisur nga parregullsitë e konstatuara, të cilat nuk cenojnë ligjshmërinë në tërësi të procesit të ristrukturimit, sepse mund të konsiderohen si të karakterit objektiv, për shkak të shkurtimit të buxhetit, lind domosdoshmëria e korigjimit të tyre:

1. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë, aktin e emërimit nr.26, datë 13.03.2015 për nëpunësin *****, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore” dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
2. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr.17, datë 02.03.2015, për punonjësin *****, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve” dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
3. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë të revokojë aktin e emërimit nr.34, datë 21.03.2014 dhe aktin nr.18, datë 02.03.2015, për punonjësin *****, në pozicionin “Specialist për Bujqësinë dhe Turizmin” në Sektorin e Kontrollit të Zhvillimit dhe në Sektorin e Shërbimeve, si dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
4. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr.38, datë 29.04.2014, për punonjësin *****, në pozicionin “Specialist për Financën”, si dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
5. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr.40, datë 29.04.2014, për punonjësin *****, në pozicionin “Specialist në sektorin e Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive” dhe rikthimin në detyrë të nëpunëses civile *****.
6. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr.36, datë 21.03.2014, për punonjësin *****, në pozicionin “Specialist në sektorin e Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive” dhe shpalljen si të lirë të këtij pozicioni pune.
7. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë të revokojë aktin e emërimit nr. 9, datë 04.06.2014, për emërimin e punonjëses ***** në pozicionin “Drejtoreshë Finance” dhe aktin e emërimit nr.25, datë 13.03.2015, për nëpunësen civile *****, në pozicionin “Përgjegjëse sektori” në Sektorin e Financës dhe shpalljen si të lirë të këtij pozicioni pune.
8. Njësia përgjegjëse të shpallë pozicione të lira pune ato të sipërcituara dhe të vijojë me procedurat e konkurimit sipas përcaktimeve të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave.
9. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes

dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (dosjen individuale).

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA